

DODA NDERTIM SH.P.K.

**Raporti i Audituesit te Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 16

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakut te Vetem të Shoqërise Doda Ndertim Sh.p.k.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë **Doda Ndertim Sh.p.k.** (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2014 si dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e fluksit të parase dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabili të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumatat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare të Shoqërisë **Doda Ndertim Sh.p.k** japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit.



25 Mars 2015

DODA NDERTIM SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	10,683,667	5,983,241
Llogari të arkëtueshme	5	3,851,450	7,386,231
Parapagime dhe shpenzime të shtyra		-	-
Inventari	6	2,896,490	3,156,536
Llogari të tjera të arkëtueshme	7	10,156,483	500,000
Total Aktiveve Afatshkurtra		27,588,090	17,026,008
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	12,807,391	12,713,358
Aktive afatgjata jomateriale		-	-
Llogari të tjera të arkëtueshme		-	-
Total aktive afatgjata		12,807,391	12,713,358
Total Aktive		40,395,481	29,739,366
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	9	7,596,184	-
Llogari të pagueshme tregëtare	10	6,541,220	6,393,922
Detyrime tatimore	11	1,908,800	312,576
Parapagime të arkëtuara		-	-
Grante, te ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Llogari të pagueshme të tjera	12	1,921,380	7,027,601
Total Detyrime afatshkurtra		17,967,584	13,734,099
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	-
Grante, te ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime të tjera afatgjata		-	-
Total Detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		25,317,842	13,734,099
Kapitali themeltar			
Kapitali themeltar		12,758,000	12,758,000
Rezerva statutore		-	-
Rezerva të tjera		2,753,189	55,459
Rezerva ligjore		494,078	352,078
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		6,422,630	2,839,730
Total kapitali	13	22,427,897	16,005,267
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		40,395,481	29,739,366

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



DODA NDERTIM SH.P.K.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga aktiviteti	14	49,170,022	27,847,125
Te ardhura te tjera		-	-
Materiale te para dhe te konsumeshme	15	(34,458,895)	(19,135,850)
Shpenzime personeli	16	(4,292,925)	(3,857,500)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	17	(1,528,640)	(1,299,000)
Shpenzime te tjera	18	(1,332,644)	(346,469)
Fitimi operativ		7,556,918	3,208,306
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	-
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto		-	(21,909)
Total shpenzime financiare	19	-	(21,909)
Fitimi para tatimit		7,556,918	3,186,397
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(1,134,288)	(346,667)
Fitimi i vitit	20	6,422,630	2,839,730

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Ramazan Doda
Administrator



DODA NDEERTIM SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera	Rezerva statutore dhe ligjore	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	12,758,000	55,459	352,078	-	-	13,165,537
Transferim në fitime të mbartura						
Fitimi i vitit		-	-			-
Pakesim i rezervave të tjera				2,839,730		2,839,730
Dividendë të paguar						-
31 Dhjetor 2013	12,758,000	55,459	352,078	-	2,839,730	16,005,267
Transferim në fitime të mbartura						
Fitimi i vitit		2,697,730	142,000		(2,839,730)	6,422,630
Transferime në rezerva të tjera					6,422,630	-
Dividendë të paguar						-
31 Dhjetor 2014	12,758,000	2,753,189	494,078	-	6,422,630	22,427,897

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i Doda Ndertim sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 15 Mars 2015 nga:

Ramazan Doda
Administrator



DODA NDERTIM SH.P.K.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Fluksit të Parasë**

Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	7,556,918	3,186,397
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,528,640	1,299,000
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga		
Interesa te perlllogaritura		280,269
Shpenzime për interesa		
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	9,085,558	4,765,666
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar	260,046	1,279,754
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(6,121,702)	(5,749,700)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	(3,362,699)	2,438,873
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra	-	-
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra	-	-
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	(138,797)	2,734,593
Tatim i paguar mbi dividendin	-	-
Tatimi mbi fitimin i paguar	(1,134,288)	(346,667)
Aktivitetet investuese	(1,134,288)	(346,667)
Blerje te aktiveve afatgjata material		
Shitje e aktiveve afatgjata material	(1,622,673)	(5,679,575)
Blerje e shoqerise se kontrolluar minus parate e arketuara		-
Interesa te marra		
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	(1,622,673)	(5,679,575)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huatë agjatgjata		
(Ripagim)/ te hyra nga hua afatshkrter		
Shtesa/pakesime ne qera financiare	7,596,184	
Dividendë paguar	-	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	7,596,184	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	4,700,426	(3,291,649)
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	5,983,241	9,274,890
Mjetet monetare ne fund te periudhës	10,683,667	5,983,241

4

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Ramazan Doda



1. TË PËRGJITHSHME

"Doda Ndertim" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 1 Mars 2000 ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Mbi Shoqerite tregtare".

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 12,758,000 Leke (dymbedhete million e shtateqind e pesedhete e tete mije Leke), i cili zoterohet nga ortaku i saj i vetem: Ramazan Doda.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte veprimtari ne fushen e ndertimit.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Tomin, Pilafe, Diber.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.



3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Leke	140.14	140.20
Usd/Leke	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe

3. POLITIKAT KONTABËL

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive Afatgjata Materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktive afatgjata materiale

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Ndertesa	5%
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiarë vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mjete monetare		
Arka	421,032	5,763,636
Banka	10,262,635	219,605
Totali	10,683,667	5,983,241

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Klientë për mallra	3,851,450	7,386,231
Totali	3,851,450	7,386,231

6. INVENTARI

Inventari për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Lende te para	-	3,156,536
Mallra për rishitje	2,818,590	-
Inventar i imet	77,900	-
Totali:	2,896,490	3,156,536



DODA NDERTIM SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë e tjera të arkëtueshme janë paraqitur tatim fitimi i parapaguar, debitorët e tjerë, tepricat e të cilave më 31 Dhjetor 2013 dhe më 31 Dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kerkesa te tjera te arketueshme	10,156,483	500,000
Totali:	10,156,483	500,000

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Ndërtesa	Makineri /Paisje dhe mjete transporti	Paisje zyre informatike	Te tjera	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2012					
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	5,188,000	13,605,670	428,500	276,855	19,499,025
Shtesa	-	1,622,673	-	-	1,622,673
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	5,188,000	15,228,343	428,500	276,855	21,121,698
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 31 Dhjetor 2012					
Amortizimi i vitit					
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	6,631,504	64,300	89,863	6,785,667
Amortizimi i vitit	259,400	1,168,700	91,190	9,350	1,528,640
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	259,400	7,800,204	155,490	99,213	8,314,307
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	5,188,000	6,974,166	364,200	186,992	12,713,358
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	4,928,600	7,428,139	273,010	177,642	12,807,391

DODA NDERTIM SH.P.K.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***9. HUATE AFASHKURTRA**

Në këtë zë është paraqitur overdrafti ne banken Societe Generale Albania me 31 Dhjetor 2014 si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua afatshkurter	7,596,184	-
Totali	7,596,184	-

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Furnitorë	6,541,220	6,393,922
Totali	6,541,220	6,393,922

11. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore, te cilat perbehen nga detyrimi i TVSH-se, sigurimet shoqerore dhe shendetesore, tatimi mbi te ardhurat dhe te tjera detyrime tatimore paraqiten më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
TVSH per tu paguar	1,281,739	128,533
Tatim fitimi	546,162	85,282
Sig Shoqerore & Shendetesore	79,599	90,761
Tatim mbi te ardhurat	1,300	8,000
Totali	1,908,800	312,576

12. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Teprica e te pagueshmeve ndaj punonjësve dhe detyrimi per pagimin e dividendit per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paga per t'u paguar	1,921,380	7,027,601
Totali	1,921,380	7,027,601

13. KAPITALI THEMELTAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 12,758,000 Leke.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore është në vlerën 494,078 Leke me 31 Dhjetor 2014.

Rezerva te tjera

Rezerva te tjera është në vlerën 2,753,189 Leke me 31 Dhjetor 2014..

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 6,422,630 Leke perfaqeson fitimin e vitit te mbyllyr më 31 Dhjetor 2014.

14. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	49,170,022	27,847,125
Totali	49,170,022	27,847,125

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 janë në vlerën prej 49,170,022 Leke. Të ardhura të deklaruar në Drejtorinë Tatimore gjatë 2014 janë në vlerën prej 49,170,022 Leke,

15. MATERIALE TE PARA DHE TE KONSUMUESHME

Kosto e materialeve te para dhe te tjera te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Lende te para dhe materiale	34,458,895	19,135,850
Totali	34,458,895	19,135,850

DODA NDERTIM SH.P.K.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***20. TATIMI MBI FITIMIN**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitim i vitit përpara tatimit	7,556,918	3,186,397
Shpenzime të pazbritshme	5,002	280,273
Fitimi fiskal para tatimit	7,561,920	3,466,670
Tatimi mbi fitimin	1,134,288	346,667

	31 Dhjetor 2014
Tatim fitimi i parapaguar 1 Janar 2014	-
Tatim fitimi i parapaguar 2014	588,126
Kompensime per gjoba dhe interesa	-
Tatim fitimi i vitit 2014	1,134,288
Tatim fitimi i parapaguar/(per t'u paguar)	546,162

21. ANGAZHIME DHE PASIGURI*Cështje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

22. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.